



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 15
Prishtinë, më 27 maj 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27 MAJ 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën e energjisë,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramiz Lladrovci, Ismet Beqiri, Rexhep Selimi, Ramiz Kelmendi, Vjosa Osmani, Zenun Pajaziti, Alma Lama, Donika Kadaj-Bujupi, Ganimete Musliu dhe Imri Ahmeti, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Rita Hajzeraj parashtroi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me procesin e njohjeve të shtetit të Kosovës për këtë periudhë të vitit 2011. Ministri Hoxhaj nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Nijazi Idrizi parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me resurset e ujërave termominerale në vend. Ministri Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Idrizi.

Deputeti Xhevdet Neziraj parashtroi pyetje për ministrin Tomiç Radoica në lidhje me kriteret e ndërtimit dhe rindërtimin të shtëpive për personat e kthyer dhe për strukturën etnike të Komuniteteve të cilat kanë përfituar në ndërtim, nga Ministria për Kthim dhe Komunitete. Ministri Radoica iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Bedri Hamza në lidhje me pagesën retroaktive të rritjes së pagave për janar dhe shkurt të këtij viti.

Ministri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me masat që ka ndërmarrë Policia e Kosovës ndaj zyrtarit Kushtrim Haliti, lidhur me protestën e paradokohshme të Lëvizjes Vetëvendosje, gjatë vizitës së përfaqësuesit të Qeverisë së Serbisë, në Prishtinë. Ministri Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Aliu.

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiç në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës dhe inspektimin eventual të kompanisë Bchtel&Enka, nga organet kompetente, për të konstatuar gjendjen reale lidhur me shfrytëzimin e fuqisë punëtore nga kjo kompani. Ministri Rashiç nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Danush Ademi parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiç në lidhje me hapat që duhet të ndërmarr ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në lidhje me zgjidhjen e problemit të banimit kolektiv të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit. Ministri Rashiç nuk ishte prezent në sallë.

3. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura me 12 e 19 maj 2011

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 12 e 19 maj 2011, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndihmë juridike falas.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se Projektligji për ndihmë juridike falas, vjen si rezultat i punës së vazhdueshme për kompletimin e legjislacionit nga fushëveprimi i Ministrisë së Drejtësisë.

Në vazhdim tha se deri më tani në vendin tonë ka munguar një Ligj i tillë, përmes të cilit do të sigurohej qasja në drejtësi e qytetarëve sidomos e atyre me gjendje të vështirë financiare, dhe se kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2006/36.

Më tutje ministri Yagcilar theksoi se ky Projektligj ka për qëllim të themelojë një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurë penale, civile, kundërvajtëse dhe administrative.

Me anë të këtij Projektligji parashihet themelimi i Këshillit dhe Agjencisë për ndihmë juridike falas, si organ i pavarur i cili është përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike falas, poashtu përcaktohen kriteret dhe llojet për përfitimin e ndihmës juridike falas, theksoi ai.

Në fund ministri kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndihmë juridike falas.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit funksional për Legjislacion, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Demolli, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kymete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Rasim Demiri, si dhe deputetja Vjosa Osmani, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndihmë juridike falas.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, vjen si rezultat i punës së vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e legjislacionit nga fushëveprimi i saj.

Në vazhdim tha se Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve përcakton masat mbrojtëse për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve dhe personave të tjerë në lidhje me procedurat penale, dhe vendosjen e rendit për zbatimin e masave të tilla mbrojtëse.

Më tutje ministri Yagcilar theksoi se ky Projektligj ka për qëllim të themelojë Drejtorinë për mbrojtjen e dëshmitarëve e cila duhet të funksionojë në kuadër të Policisë së Kosovës.

Në fund ministri kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit, mungesa e të cilit Ligj theksohet edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2011.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë:, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Duda Balje, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Haki Demolli, Blerim Shala, Fatmir Xhelili, Hydajet Hyseni, Arben Gashi, Xhavit Haliti, Behar Selimi dhe Zenun Pajaziti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën e energjisë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Ministri **Besim Beqaj** tha se Projektligji për eficiencën e energjisë, rregullon promovimin e eficiencës së energjisë, përgatitjen dhe miratimin e planeve të eficiencës së energjisë dhe detyrat e sektorit publik nga kjo fushë, dhe themelimin e institucioneve përkatëse për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Në vazhdim tha se ky Projektligj është harmonizuar me legjislacionin e BE-së nga kjo fushë, në të cilin bënë pjesë edhe Direktiva 2006/32/ EC.

Më tutje ministri Beqaj tha se me këtë Projektligj është paraparë themelimi i Agjencisë së Kosovës për eficiencën së energjisë, të krijojë Komisionin për certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë, të zhvillojë politikat e eficiencës së energjisë si pjesë e Strategjisë së Kosovës për energji, etj.

Në përfundim të ekspozesë së tij, ministri konstatoi se Projektligji përbëhet prej 12 neneve dhe nuk ka kosto të lartë financiare.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për eficiencën e energjisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Enis Kervan, si dhe deputetja Justina Shiroka-Pula dhe ministri Besim Beqaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,

Kundër----- 1,

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri , si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi, njoftoi Kuvendin, se Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, i ka parashtruar Kuvendit, Propozim-vendimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim, dhanë: në emër të komisionit funksional për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinkoviç, që janë dhënë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimin për emërimin e z. Bedri Bahtiri, anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Bedri BAHTIRI, emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
2. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, është dy (2) vjet.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010

Deputeti **Idriz Vehapi**, në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviç, dhe deputetët: Time Kadrijaj dhe Lutfi Haziri që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	70,
Kundër-----	4,
Abstenime-----	3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostić, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, dhe deputetët: Suzana Novoberdaliu, Ali Sadriu, Nehat Idrizi, Hydajet Hyseni, Shaip Muja, Lutfi Haziri dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	46,
Kundër-----	12,
Abstenime-----	7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010

Kryesuesi, njoftoi Kuvendin, se Komisioni Funksional Komisioni Funksional për Legjislacion, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ai tha se gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar këtë Raport, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Lundrim Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, dhe deputetët: Sadri Ferati dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	51,
Kundër-----	13,
Abstenime-----	5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

Në fund të mbledhjes plenare, Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që të dërgojnë nga një përfaqësues, në takim me grevistët e Këshillit për mbrojtjen e të drejtave të veteranëve të UÇK-së, që ata t’i informojnë se Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së pritet të procedohet së shpejti në Kuvend.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale.